

**AKT THEMELIMI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**

Ingenious Marketing Solutions

Sot, më datë 16.09.2021, personalisht:

- **Grigor PASHKO**, i biri i Kozma-it, i datëlindjes 12.09.1995, shtetas shqiptar, lindur ne Erseke dhe banues ne Rr. Robert Shvarc, Tirane, person madhor me zotësi të plotë për të vepruar, me cilësinë e ortakut të shoqërisë tregtare Ingenious Marketing Solutions Sh.p.k.

Përpilon këte akt themelimi të shoqërisë tregtare **Ingenious Marketing Solutions sh.p.k.**, me termat e mëposhtme:

NENI 1

Të themelojë Shoqerinë Tregtare Ingenious Marketing Solutions Sh.P.K, në formën e një Shoqërie me përgjegjësi të kufizuar. Në të gjitha aktet që do të nxjerrë shoqëria kundrejtuar të tretëve si dhe në të gjitha aktet e brendshme të saj, do të shënohet detyrimisht emri Ingenious Marketing Solutions Sh.P.K, sipas përcaktimeve të bëra në këtë Akt Themelimi dhe në Statut.

NENI 2 Qëllimi i krijimit të Shoqërisë.

Qëllimi i krijimit të kësaj Shoqërie është zhvillimi i aktivitetit ekonomik në fusha të ndryshme. Veprimtaria e kësaj Shoqërie do të jetë thellësisht me karakter ekonomik dhe qëllim fitimprurës.

NENI 3 Emri dhe vula e shoqërisë

Shoqëria, do të dalë në qarkullimin juridiko - civil me emrin e subjektit Ingenious Marketing Solutions Sh.P.K dhe me emrin tregtar Ingenious Marketing. Ajo do të ketë edhe vulën e saj.

NENI 4 Objekti i veprimtarisë

Veprimtaria e shoqërisë do të jetë:

Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm :

I. Përgatitje, krijim (web design) implementim dhe mirëmbajtje faqe interneti, ofrim domain, shërbim web hosting, programe kompjuterike (software), aplikacione në të gjitha platformat për web, desktop, mobile etj, menaxhim i rrjetave sociale, realizimin e fushatave reklamuese etj.

II. Shërbime Marketingu, telemarketingu, teleselling me shërbime Call Center apo Contact Center si Outbound (telefonata në dalje), Inbound (telefonata në ardhje), Customer Service (asistencë klientesh), Help Desk (suport teknik), numra të gjelbër, mesazhe promocionale etj.



III. Shërbime ndërmjetësimi biznesi, kërkim dhe studim tregu, sondazhe, nëpërmjet shërbimit telefonik ose fizikisht në terren dhe çdo lloj tjeter aktiviteti apo konsulencë të lidhur me sa më lart.

NENI 5 Selia e Shoqërisë dhe Afati

Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën: Njesia Administrative Nr.2, Rr.Jeronim De Rada, Pll Renis, Nj.3, Tirane.

Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj për një periudhe kohore pa afat.

NENI 6 Kapitali i Shoqërisë

Kapitali themeltar eshte 100.000 (njeqind mijë) Lek dhe zotërohet nga ortaku themelues.

Vlera totale e kapitalit te regjistruar: 100.000 leke, vlore e cila eshte paguar plotesisht.

Numri total i kuotave: 1.

Kapitali themeltar eshte mbuluar tërësisht nga ortaku i vetem themelues.

NENI 7

Ortaku i vetem themelues i Shoqërisë Tregtare Ingenious Marketing Solutions Sh.p.k zotëron kuotat në këtë shoqëri si më poshtë:

- Grigor PASHKO: pjesemarrja ne perqindje 100 %, 1 kuotë, lloji i kontributit para, 100.000 (njeqind mijë) Leke, kontribut i cili eshte paguar plotesisht dhe menjëherë.

NENI 8 Organet Drejtuese

Duke ju referuar ligjit nr. 9901, datë 14/04/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, organet drejtuese të shoqërisë janë si më poshtë vijon:

1. Ortaku i Vetem – organi më i lartë vendimarrës;
2. Administratori – organi ekzekutiv dhe administrativ i shoqërisë.

NENI 9 Administratori

Shoqëria administrohet nga ana e Administratorit i cili zgjidhet për një mandat 4 (kater) vjeçar me të drejtë rizgjedhje. Administratori i parë i shoqërisë do të jetë **Z. Grigor Kozma PASHKO**.

Shoqëria përfaqësohet para çdo organi administrativ, gjyqësor, enti publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga administratori, i cili i ushtron këto të drejta në përrputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.

NENI 10

Oratku mund të vendose me vullnetin e tij, për pjesmarjen në Shoqëri të tjera dhe të krijojë çdo lloj aktiviteti tjetër privat, me përjashtim të kufizimeve të përcaktuara me ligj.

NENI 11

Të punësuarit dhe të ngarkuarit me drejtimin e Shoqërisë mbajnë përgjegjësi dhe detyrohen të zhdëmtojnë Shoqerinë për dëmet që i janë shkaktuar për faj të tyre.

NENI 12

Mosmarrveshjet për themelimin e Shoqërisë zgjidhen me mirekuptim dhe kur kjo nuk arrihet, ato zgjidhen nga Gjykata kompetente.

NENI 13

Te dhena qe njoftohen vullnetarisht:

Emri tregtar: Ingenious Marketing

Email : grigori_o@hotmail.com


Tel : 0699714726

NENI 14

Akti i themelimit pasi u lexua nga Ortaku Themelues u get sipas vullnit të tij dhe u nënshkrua pa vërejtje. Akti i Themelimi hartohet në gjuhën shqipe.

ORTAKU I VETEM THEMELUES

Grigor PASHKO

A handwritten signature in blue ink, appearing to read "Grigor Pashko", with a stylized "GP" monogram underneath.